



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE



dogana.shqiptare



Dogana Shqiptare

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Shtator 2025

FORUMI BIZNES - DOGANA / SHQIPËRIA DREJT UNIONIT DOGANOR TË BE 2027



Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, zhvilloi forumin e radhës **“Biznes – Dogana”**, i cili kishte në fokus lehtësimin e procedurave dhe digjitalizimin e shërbimeve doganore. Ky forum shënon një moment të rëndësishëm në procesin e dialogut mes administratës doganore dhe komunitetit të biznesit, në një kohë kur Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të integritimit evropian.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, theksoi rëndësinë e përfshirjes aktive të biznesit në këtë proces: Ai prezantoi Strategjinë e re për digjitalizimin e sistemeve doganore, e cila përfshin modernizimin e platformës **“ASYCUDA World”** dhe kalimin në sisteme të përditësuara, të afta për ndërveprim me platformat doganore të BE-së. Strategjia parashikon lehtësim të procedurave, ulje të kohës së zhdoganimit, rritje të transparencës dhe një mjedis më konkurrues për biznesin shqiptar.

Nga ana e tij, Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, z. Nikolin Jaka, vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë me Doganat dhe arritjet e deritanishme, si digjitalizimi i shërbimeve përmes platformës **e-Albania**, reduktimi i kohës së përpunimit të deklarave dhe zgjerimi i statusit **Operator Ekonomik i Autorizuar (AEO)**. Forumi u mbyll me një mesazh të përbashkët: Bashkëpunimi Doganë – Biznes është çelësi për ta çuar Shqipërinë drejt Unionit Doganor të BE- së deri në vitin 2027, duke krijuar një mjedis tregtar më efikas, transparent dhe konkurrues.

TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E DOGANËS FRANCEZE

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, zhvilloi një takim pune me Atasheun Doganor pranë Ambasadës së Francës për Europën Juglindore dhe rajonin e Ballkanit, z. Hugues Chevalier, si dhe me zëvendësin e tij, z. Benjamin Offroy. Qëllimi i takimit ishte forcimi i bashkëpunimit mes Doganës Shqiptare dhe Doganës Franceze, duke shkëmbyer eksperiencën dhe praktikat të mira në fushën doganore.



Z. Gazheli informoi përfaqësuesit francezë mbi përpjekjet e vazhdueshme të Administratës Doganore Shqiptare për të përmbyshur detyrimet dhe standardet në kuadër të Kapitullit 29 – Bashkimi Doganor, si pjesë e procesit të integritimit evropian. Ai theksoi se Dogana Shqiptare është e angazhuar plotësisht në përmbyshjen e reformave dhe detyrimeve që lidhen me aderimin në familjen e madhe doganore të Bashkimit Evropian. Nga ana e tij, Atasheu Doganor francez, z. Chevalier, vlerësoi progresin e bërë nga pala shqiptare dhe theksoi gatishmërinë e Doganës Franceze për të mbështetur këtë proces.

DREJTORI I DOGANAVE TAKOHET ME EKIPIN E BANKËS BOTËRORE PËR PROJEKTIN TTFP 2.0

Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u zhvillua një takim pune mes Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, Genti Gazheli dhe ekipit të Bankës Botërore, në kuadër të misionit përgatitor të projektit **“Western Balkans Trade and Transport Facilitation Project 2.0 (TTFP 2.0)”**.

Gjatë takimit u diskutuan:

- përmirësimi i sistemeve të Administratës Doganore (ACA) dhe ndërlidhja me agjenci të tjera
- shtetërore;
- projekti Green Lane në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë dhe diskutime mbi pika të tjera
- kufitare;
- granti për Programin e Transportit të Sigurt dhe të Qëndrueshëm (SSTP);
- modernizimi i laboratorit doganor;
- prioritetet e tjera të Administratës Doganore.



DOGANA SHQIPTARE RRIK KAPACITETET NË FUSHËN E SIGURISË BËRTHAMORE DHE RADIOLOGJIKE

Në datat 9-11 shtator u zhvillua në Tiranë workshop-i treditur i organizuar nga Zyra e Zbulimi dhe Parandalimit të Kontrabandës së Lëndëve Bërthamore (**Nuclear Smuggling Detection and Deterrence – NSDD**) pranë Departamentit të Energjisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Workshop-i **“Contraband Detection and Interview Techniques (CDIT)”** synon të përmirësojë aftësitë e Doganës Shqiptare në fushën e zbulimit dhe parandalimit të kontrabandës së materialeve radioaktive dhe bërthamore. Ky aktivitet përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të sigurisë kufitare dhe mbështetjes së përpjekjeve kombëtare e ndërkombëtare për parandalimin e terrorizmit bërthamor dhe radiologjik.



DOGANA SHQIPTARE NË FOKUS TË SFIDËS “SHQIPËRIA 2030”

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, zhvilloi një takim pune me stafin e Administratës Doganore në Durrës. Gjatë këtij takimi u nënvizua rëndësia e përmbyshjes së objektivave të vendosura, me fokus të veçantë në sfidën madhore të Shqipërisë 2030 për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, ku Dogana Shqiptare ka një rol kyç në drejtimin e Kapitullit 29 të negociatave.

Drejtori i Përgjithshëm vuri theksin te energjizimi i stafit dhe angazhimi i përbashkët për të finalizuar me sukses planin vjetor të punës, duke synuar mbylljen e vitit me rezultate të larta. Ky takim ishte gjithashtu një moment për të vlerësuar punën e deritanishme dhe për të rritur frymën e bashkëpunimit në arritjen e objektivave strategjike që forcojnë rolin e Doganës në procesin e integritimit evropian.



DREJTORI I DOGANAVE TAKIM NË BRUKSEL ME PËRFAQËSUESIT E DG TAXUD

Bruksel - Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Shqiptare, z. Genti Gazheli, zhvilloi një takim pune me Drejtorin e Doganave në Komisionin Evropian (**DG TAXUD**), z. Matthias Petschke, dhe stafin e tij.

Diskutimet u përqendruan te zbatimi i udhërrëfyesit të Kapitullit 29, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.



Z. Gazheli ritheksoi angazhimin e Administratës Doganore për përafrimin e legjislacionit doganor me atë të BE-së, forcimin e kapaciteteve administrative dhe infrastrukture, si dhe implementimin e sistemeve digjitale moderne. Përfaqësuesit e DG TAXUD vlerësua maksimalisht përpjekjet dhe progresin e arritur nga Doganat Shqiptare.

➡ **ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE MIRËPRET NË TIRANË
WORKSHOPIN MBI RREGULLAT E ORIGJINËS, ORGANIZUAR
NGA CEFTA**



Tiranë - Në kuadër të kryesimit shqiptar të Nënkomitetit të CEFTA për Doganat dhe Rregullat e Origjinës, në Tiranë u zhvillua workshop-i dyditor mbi Rregullat e Origjinës, i organizuar nga CEFTA, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga DG TAXUD i Komisionit Evropian, si dhe ekspertë të fushës.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Shqiptare, z. Genti Gazheli, shprehu kënaqësinë për mikpritjen e këtij aktiviteti në Tiranë, duke theksuar rëndësinë e përbashkët të bashkëpunimit doganor dhe përafrimit me praktikën e BE-së. Ai nënvizoi rezultatet e arritura gjatë kryesimit shqiptar të Nënkomitetit për Doganat dhe Rregullat e Origjinës, si krijimi i Trupit Këshillimor të CEFTA-s për Bashkëpunimin Doganor mbi Klasifikimin Tarifor dhe Rregullat e Origjinës, si dhe i Grupit të Punës për Operatorin Ekonomik të Autorizuar.

Ai falënderoi ekspertët e DG TAXUD për mbështetjen e vazhdueshme dhe ndau detaje nga takimi i fundit në Bruksel me Drejtorin e Doganave të Komisionit Evropian, z. Matthias Petschke, mbi ecurinë e zbatimit të Kapitullit 29 “Bashkimi Doganor” në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

➡ **FORCIMI I KAPACITETEVE TË ANTIKONTRABANDËS, PRIORITET PËR PROCESIN E INTEGRIMIT**

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Z. Genti Gazheli zhvilloi një takim me Drejtorinë e Antikontrabandës, strukturën më të madhe ligjzbatuese të sistemit doganor. Ky takim zhvillohet në vijim të serisë së takimeve që Drejtori i Përgjithshëm ndërmerr me strukturat drejtuese të DPD-së dhe me degët doganore, në kuadër të vizionit “Shqipëria 2030”/“Dogana 2030”.

Qëllimi kryesor është përgatitja e Administratës Doganore për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ku dogana, për shkak të misionit dhe pozicionit të saj, ka një rol kyç në përmbushjen e standardeve për mbrojtjen e kufijve të jashtëm të BE-së si dhe interesave ekonomike e fiskale të saj.

Z. Gazheli i kërkoi kësaj strukture një energjizim dhe ndërgjegjësim të ri, një mënyrë të re të të menduarit e të vepruarit, me qëllim forcimin e kapaciteteve për parandalimin dhe zbulimin e shkeljeve doganore në të gjithë territorin. Ai theksoi domosdoshmërinë e përvetësimit të përvojave më të mira të strukturave ligjzbatuese doganore të vendeve të BE-së.



➡ **DOGANA SHQIPTARE NDALON DISA
RASTE MALLRASH QË CENOJNË
PRONËSINË INTELEKTUALE NË
KAPSHTICË**

Kapshticë – Strukturat e Degës Doganore Kapshticë, në bashkëpunim me Grupin e Antikontrabandës, kanë finalizuar disa raste bllokimi të mallrave të dyshuara si falsifikime të markave të mbrojtura tregtare. Gjatë një kontrolli të detajuar mbi një mjet të ardhur përmes kësaj pike doganore në 24 shtator, u evidentuan sasi të konsiderueshme artikujsh veshjesh dhe aksesorësh me logo të markave ndërkombëtare të njohura. Ky rast vjen pas dy bllokimeve të tjera të kryera më 22 dhe 23 shtator 2025 në të njëjtën pikë doganore.

Dogana shqiptare vijon të jetë e angazhuar në mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si pjesë e angazhimeve për forcimin e integritetit tregtar dhe garantimin e një tregu të drejtë për konsumatorët dhe bizneset.



➡ **EU4LEA 2: ADMINISTRATA DOGANORE ANGAZH OHET NË FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT
INSTITUCIONAL**

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, mori pjesë në Eventin e Prezantimit të Projektit EU4LEA 2, i organizuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe ekipi i projektit EU4LEA 2. Ky projekt, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane, synon të mbështesë Shqipërinë në procesin e anëtarësimit në BE, duke forcuar sundimin e ligjit dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet përfituese, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeprokurorin e Posaçëm, si dhe partnerë ndërkombëtarë. Pjesëmarrja e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në këtë event nënvizon angazhimin e Administratës Doganore për të qenë pjesë aktive e proceseve të bashkëpunimit institucional dhe për të kontribuar në forcimin e kapaciteteve ligjzbatuese në Shqipëri.

➡ **ZGJATET ORARI I PUNËS PËR KAMIONËT NË DEGËT DOGANORE
KAPSHTICË DHE KAKAVIJË**

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, vizitoi Doganën e Qafë Thanës, duke u njohur nga afër me punën e përditshme dhe sfidat e stafit doganor në këtë pikë kufitare të rëndësishme me Maqedoninë e Veriut.

Orari i ri: Nga ora 22:00 deri në 00:00 (sipas orës greke). Ky ndryshim hyn në fuqi duke filluar nga e hëna, **6 tetor 2025**. Ky zhvillim është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet administratave doganore dhe synon të lehtësojë fluksin në degët doganore, duke krijuar kushte më efikase për transportin ndërkufitar.



➡ **VIZITË NË DOGANËN E QAFË THANËS**

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, vizitoi Doganën e Qafë Thanës, duke u njohur nga afër me punën e përditshme dhe sfidat e stafit doganor në këtë pikë kufitare të rëndësishme me Maqedoninë e Veriut.

Gjatë bashkëbisedimit me punonjësit, u ndal te rezultatet e deritanishme të performancës së administratës dhe rëndësia e ruajtjes së standardeve të larta në ofrimin e shërbimeve doganore. Në mesazhin e tij, Drejtori vuri theksin te domosdoshmëria për të vijuar me të njëjtin intensitet dhe profesionalizëm, si pjesë e vizionit afatgjatë “Dogana 2030” dhe rrugëtimit drejt “Shqipërisë Europiane”.



➡ **PREZANTOHET VERSIONI DEMO I SISTEMIT TË TRANZITIT TË PËRBASHKËT ME BE: NCTS, FAZA 5**

Në kuadër të Projektit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor, të financuar nga Banka Botërore, u zhvillua në Doganën e Tiranës prezantimi i versionit DEMO të sistemit të tranzitit të përbashkët me Bashkimin Evropian – NCTS, Faza 5.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga disa dogana të rëndësishme kufitare, si dhe drejtues dhe specialistë të fushës. Në takim ishte i pranishëm edhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, i cili theksoi rëndësinë e këtij zhvillimi, duke u shprehur se: “Sistemi i ri i Kompjuterizuar i Tranzitit (NCTS) ofron procedura lehtësuese, moderne dhe të harmonizuara sipas standardeve të Bashkimit Evropian, duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta për biznesin dhe për administratën doganore.”

Implementimi i NCTS Faza 5 përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të plotë të doganave shqiptare, ndërkohë që janë në proces procedurat me Bankën Botërore për kalimin në një version edhe më të avancuar – NCTS Faza 6. Për këtë fazë tashmë janë përgatitur dhe miratuar termat e referencës, duke i mundur Shqipërisë një hap tjetër të sigurt drejt doganave evropiane.



➡ **VIZITË NË DOGANËN E KAPSHTICËS**

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, zhvilloi një vizitë pune në Doganën e Kapshticës, një nga portat hyrëse kryesore të vendit me kufirin grek. Në takim me stafin, u diskutua mbi rezultatet e performancës së 8-mujorit dhe u dha mesazhi për të vijuar me të njëjtin ritëm dhe energji në punë.

Drejtori theksoi se këto rezultate janë pjesë e rrugëtimit drejt objektivit madhor “Shqipëria Europiane” dhe vizionit strategjik “Dogana 2030”, duke nënvizuar rëndësinë e modernizimit dhe forcimit të kapaciteteve të administratës doganore.

